



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN**

Elbasan, më / /2022

**Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall**

*(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)*

**OBJEKTI I PROÇEDURËS-“ Furnizim dhe vendosje kaldaje për QEA”**

**LLOJI PROÇEDURËS- “Proçedurë e hapur e thjeshtuar – mallra”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: 42310000-2 - Kaldaja me djegie**

**VLERA E FONDIT LIMIT - 4,225,000 (katërmilion e dyqind e njëzet e pesë mijë) lekë pa t.v.sh..**

Ne bazetenenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhenenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si mëposhte:

**Shtojca 7**

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

## **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

**Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.**

**Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 03 Datë 09.06.2021 të miratuara nga APP.**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. Formulari i Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

**Kriteret (a-c) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 03 Datë 09.06.2021 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”.**

**Pika b) është vendosur në bazë të nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**

### **2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:**

Sipas shtojces 7;

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.2.1** Kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrata tatimore pergjate tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet të jete jo me e vogel se **40%** e vleres se fondit limit.

**2.2.2** Kopjen e çertifikuar të bilanceve për tre vitet e fundit të paraqitura në autoritetet përkatëse. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**2.2.3** Operatori ekonomik duhet të paraqese një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifave vendore për vitin **2022 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifave vendore).

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

Kriteri **2.2.1** është vendosur referuar nenit 43 dhe nenit 55 pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,si dhe bazuar ne Nenin 77 pika 3,e LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

Kriteri **2.2.2** është vendosur referuar nenit 43, pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar ne Nenin 77 pika 3,e LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

Kriteri**2.2.3** eshte vendosur bazuar ne nenin 76, pika 2 te LPP sidhe ne ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

## **2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:**

**2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vleres se**

perillogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik ose fatura tatimore te shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara,

**ose**

**Në rast se pervoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat**,si deshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi,dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara

Kriteri **2.3.1** është vendosur referuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 55, pika 4 germa b) te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”si dhe bazuar ne nenin 77 pika 4 te LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

### **2.3.2 Operatori ekonomik duhet te disponoje dhe te paraqese certifikaten e vlefshme:**

- **SSH/ EN-ISO 9001-2015** “Sistemi i Menaxhimit te Cilesise” **ose ekuivalente, e vlefshme**, elidhur me objektin e prokurimit

Çertifikata e mesiperme duhet te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Kriteri **2.3.2** eshte vendosur ne perputhje me Nenin 40 pika 6 germa c te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, bazuar ne nenin 44 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 si dhe bazuar ne nenin 79 te LPP.

Ky kriter eshte vendosur qe AK te kete sigurine qe operatori ekonomik qe do te ofertoje te jete i pajisur me certifikaten e menaxhimit te cilesise gje e cila krijon bindjen dhe sigurine te AK qe ky OE do te ofertoje produkte te certifikuara te nje cilesie te mire e ne perputhje me standartet nderkombetare te cilesise.

**2.3.3** Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin perkates te publikuar ne SPE, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara,

operatori ekonomik nëse nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi/furnizimi nga prodhuesi/distributori, për mallin Kaldaje objekt prokurimi.

Në rast paraqitjeje të autorizimit nga Distributori duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur pasi është në përputhje me objektin e prokurimit dhe bazuar në nenin 40, pikë 6 germa b dhe pikë 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pikë 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pikë 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pikë 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **NJESIA E PROKURIMIT**